

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të dorëzuar nga A1 TELEKOM AUSTRIA AG, me seli në Lasaleshtrase 9, 1020, Vjenë, Austri, përmes Martin Ivanov, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 22.05.2024, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin A1 TELEKOM AUSTRIA AG, me seli në Lasaleshtrase 9, 1020, Vjenë, Austri do të fitojë kontroll mbi NTT Austria GmbH me seli të regjistruar në Austria Kampus 3, Jakon-Lind-Shtrase 5/4, 1020 Vjenë, Austri, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë të tij thelbësore, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptimin e nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit është i detyruar të paguajë tarifën administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6.000 denarë dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000 denarë, sipas numrit tarifar nr. 34 të Ligjit për Taksa Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 30.04.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua një njoftim për përqendrim nga A1 TELEKOM AUSTRIA AG, me seli në Lasaleshtrase 9, 1020, Vjenë, Austri, me të cilin A1 TELEKOM AUSTRIA AG do të fitojë kontroll mbi NTT Austria GmbH me seli të regjistruar në Austria Kampus 3, Jakov-Lind-Shtrase 5/4, 1020 Vjenë, Austri, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe, bazuar në të dhënat e dorëzuara në njoftim dhe shtesat përkatëse, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Veprimtaritë e **A1 TELEKOM AUSTRIA AG** përfshijnë shërbime bazë të telekomunikacionit, qasje në internet, televizion kabllor digjital, teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK), shërbime me shumicë, si dhe zgjidhje për bizneset në lëvizje dhe zgjidhje pagesash.

A1 TELEKOM AUSTRIA AG është pjesë e Grupit A1 Telekom Austria dhe është në pronësi të drejtpërdrejtë të Telekom Austria AG, Austri ("Telekom Austria")¹. Telekom Austria AG është një kompani holding që nuk ofron asnjë shërbim. Portofoli i Grupit A1 Telekom Austria përfshin aktivitete në fushat e telefonisë zanore, qasjes në internet me brez të gjerë, shërbime multimediale, zgjidhje të të dhënave dhe IT.

Grupi A1 Telekom Austria është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes:

- A1 MAQEDONIA SHPKNJ Shkup, me seli në Sheshin Zonja e Bekuar nr. 1, Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në telekomunikacionet pa tel;
- TELEMEDIA SHPKNJ Shkup, me seli në Sheshin Zonja e Bekuar nr. 1, Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në shpërndarjen e programeve filmike, video dhe televizive;
- LinVorks SHPKNJ Shkup me NUAS 7556381, me seli në Sheshin Zonja e Bekuar nr. 1, Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në programimin kompjuterik.

NTT Austria GmbH është ofrues i pajisjeve harduerit dhe softuerit për IT dhe fokusohet në integrimin e sistemeve dhe shërbimet e menaxhuara. NTT Austria GmbH ofron shërbime të personalizuar dhe siguron praktikat më të mira në dizajn dhe operacione përmes qendrave të saj të sigurta, të shkallëzuara dhe të përshtatshme të të dhënave. Sidoqoftë, këto aktivitete janë të kufizuara në territorin e Austrisë dhe NTT Austria GmbH nuk ka asnjë aktivitet në territorin e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

¹ Kontrolli i vetëm mbi Telekom Austria AG ushtrohet nga shoqëria Amerika Movil S.A.B. de C.V.. Amerika Movil është aktive në Amerikën Veriore, Qendrore dhe Jugore. Oferta e produkteve të Amerika Mobile Group përfshin shërbimet e telefonisë celulare dhe fikse, aksesin me brez të gjerë dhe televizionin.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска